



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në seancën e 50-të, të mbajtur më datë 21 korrik 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 09 –2351/1 të datës 09.04.2019 NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka bazë për veprimin e tij kompetent në lëndën me numër 09-2351 / 1 nga 09.04.2019, sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përcaktimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Lënda me numër 09 –2827/1 të datës 23.05.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Arsyetim

Lënda me numër 09 –2351/1 nga 09.04.2019 u formua në bazë të denoncimit anonim nga një grup qytetarësh nga Komuna -----, i cili i referohet pretendimeve për nepotizëm të Kryetari i Komunës -----, gjatë emërimit të drejtorit të shkollës në Komunë -----, sipas parashtruesit, personi i emëruar është kunati (vëllai i gruas të Kryetarit të Komunës)

Pas shqyrtimit të denoncimit, u konstatua se në rastin konkret duhet të vepron Njësia për Parandalimin e Korrupsionit , sepse në denoncimka pohime se Kryetari i Komunës ----- zotëron objekt hotelierie dhe para restorantit të tij ka përvetësuar tokë të bërë si një kopsht veror.

Në seancë, pas shqyrtimit në të gjitha pohimet që janë bërë në lëndë, Komisioni Shtetëror, duke filluar nga kompetencat e tij të përcaktuara në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave, konstaton se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të filluar procedurë për përcaktimin e gjendjes së konfliktit të interesit në përputhje me nenin 76 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, dmth. nuk ka pohime, nuk theksohet se në cilën shkollë kryetari i komunës emëroi personin e tij të afërt, dhe as nuk jepen të dhëna për personin që u emërua, dhe pasi që bëhet fjalë për një denoncim anonim , Komisioni Shtetëror nuk mund të kërkojë sqarime të mëtejshme të së njëjtës.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHETETOROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Kryetar

Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së

Punoi: SM, bashkëpunëtor i larë

Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së